

VENDIM
Nr. 27, datë 10.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 10.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (Q) 2025, që u përket:

KËRKUES: QAZIM MUSABELLIU, përfaqësuar nga Eriold Musabelliu, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 918, datë 25.6.2025, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8 dhe 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkesit Qazim Musabelliu (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit (*i paditur kundërpaditës në procesin gjyqësor*), me vendimin nr. 3, datë 30.6.1999 (*vendimi nr. 3/1999*) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Skrapar, i është njohur dhe kthyer një sipërfaqe 56 ha kullotë, e ndodhur në vendin e quajtur “Kulmak”. Me vendimin nr. 227, datë 23.12.2002 (*vendimi nr. 227/2002*) të KKKP-së, Berat, Kryegjyshatës Botërore Bektashiane (*paditës i kundërpaditur në procesin gjyqësor*), i është njohur pronësia për një sipërfaqe kullote 245 ha, duke iu kthyer sipërfaqja 189 ha, pasi sipërfaqja tjetër 56 ha kullotë i është njohur dhe kthyer më parë kërkuesit.

2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane i është drejtuar gjykatës me padi me objekt anulimin e vendimit nr. 3/1999 të KKKP-së, Skrapar dhe kthimin e plotë të sipërfaqes 245 ha. Kërkuesi ka paraqitur kundërpadi me objekt anulimin pjesërisht të vendimit nr. 227/2002 të KKKP-së, Berat.

3. Me vendimin nr. 125/1337, datë 7.10.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur pranimin e padisë, duke anuluar vendimin nr. 3/1999 të KKKP-së, Skrapar dhe kthyer

paditëses, Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, sipërfaqen 56 ha, si dhe pranimin pjesërisht të kundërpadisë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 227/2002 të KKKP-së, Berat. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 582, datë 9.6.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Me vendimin nr. 614, datë 26.11.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve të mësipërme të gjykatave të faktit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, me tjetër trup gjykues.

4. Me vendimin nr. 237, datë 17.3.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur deklarimin e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Vlorë, si gjykata kompetente. Mbi ankimin e kërkesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2018-21, datë 18.1.2018, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 237, datë 17.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe kthimin e çështjes në atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

5. Në datën 14.2.2018 çështja e kërkesit është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me nr. 555/103/65/61/56/55/47 regjistri. Për shkak se çështja e tij nuk ishte shqyrtuar ende, në datën 20.1.2025 kërkuesi i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë për informacion për ecurinë e çështjes së tij. Me marrjen në shqyrtim të kësaj kërkesë, gjyqtarja relatore e çështjes ka planifikuar shqyrtimin e saj në datën 31.3.2025. Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të një gabimi njerëzor në planifikim, pasi data e caktuar përkonte me ditë pushimi zyrtar. Më pas, gjyqtarja relatore ka planifikuar një seancë tjetër në muajin maj të vitit 2025.

6. Në datën 8.4.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe urdhërimin e masave të nevojshme e të domosdoshme për përfundimin e gjykimit të çështjes së tij.

7. Me vendimin nr. 918 (30-2025-5519), datë 25.6.2025, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkesit si të pambështetur në prova dhe në ligj, duke arsyetuar se vonesa në shqyrtimin e çështjes nuk ka ardhur si pasojë e neglizhencës nga ana e gjyqtarës relatore, por për shkak të pamundësisë objektive për shqyrtimin e saj, shkaqe të njohura edhe në ligj si të tilla. Gjithashtu, sipas asaj gjykate, natyra komplekse e çështjes, e cila përfshin padinë dhe kundërpadinë, volumi i lartë i dosjes gjyqësore, si dhe nevoja për përgatitje të kujdesshme nga trupi gjykues i sapocaktuar, justifikojnë kohën e nevojshme për një shqyrtim të drejtë dhe efektiv të saj.

8. Në datën 24.10.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 16.1.2026, bazuar në nenin 21, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi pavarësisht se kanë kaluar më shumë se 8 vjet nga regjistrimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë, kjo e fundit nuk e ka shqyrtuar ende. Gjyqtarja L.Xh. është caktuar relatore e çështjes në datën 23.10.2023 dhe deri në datën 26.2.2025, kur kërkuesi ka kërkuar informacion për ecurinë e gjykimit, ajo nuk kishte marrë asnjë masë me qëllim zhvillimin e gjykimit. Kërkuesi ka shfaqur interes për ecurinë e çështjes dhe nuk është bërë shkak për shtyrjen e gjykimit të saj. Për më tepër, çështja nuk paraqitet komplekse, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj i ka përcaktuar detyrat e lëna

për gjykatën e rigjykimit. Edhe pse ka kërkuar nga gjykata e apelit përshpejtimin e gjykimit të çështjes, kërkesa e kërkuarit është rrëzuar.

9.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në vendimin e gjykatës së apelit nuk janë pasqyruar ndryshimet e përsëritura të trupit gjykues gjatë viteve dhe se konkluzionet e pjesës arsyetuese të këtij vendimi nuk bazohen në aktet ligjore dhe në parimet e rregullat që karakterizojnë mendimin logjik.

9.3. *Detyrimit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës*, të cilat kanë elaboruar standardin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, për shkak se nuk janë zbatuar në rastin e kërkuarit dhe, për më tepër, gjykata e apelit ka përdorur arsytetime haptazi jologjike.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Gjykata vlerëson se kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen gjyqësore për të cilën ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Për sa i përket kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual pasi i është drejtuar më parë gjykatës së apelit me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, në zbatim të nenit 399/6, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së. Kjo kërkesë e kërkuarit është rrëzuar me vendimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i cili është dhe objekti i ankimit kushtetues, për rrjedhojë Gjykata çmon se i vetmi mjet në dispozicion të kërkuarit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

13. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi objekt kërkesë, që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes, mban datën 25.6.2025, kurse ankimi kushtetues është paraqitur në datën 24.10.2025, pra brenda afatit 4-mujor.

14. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, si edhe në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe detyrimit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës*, pretendime të cilat, edhe pse janë ngritur si të mëvetësishme, në thelb kanë të bëjnë me mënyrën sesi ka arsyetuar dhe argumentuar gjykata e apelit qëndrimin e saj për rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit në shkallë të parë dhe përshpejtimin e procedurave. Për rrjedhojë, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, ato do të trajtohen në vijim në këndvështrim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuesi ka pretenduar se edhe pse çështja e tij është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Berat në datën 14.2.2018 dhe pavarësisht se kanë kaluar gati 8 vjet, ajo nuk është gjykuar ende. Sipas kërkuesit, gjyqtarja L.Xh. është caktuar relatore e çështjes në datën 23.10.2023 dhe deri në datën 26.2.2025, kur ai ka kërkuar informacion për ecurinë e çështjes, ajo nuk kishte marrë asnjë masë me qëllim zhvillimin e gjykimit. Kërkuesi ka parashtruar se ka shfaqur interes për ecurinë e çështjes dhe nuk është bërë shkak për shtyrjen e gjykimit të saj, duke kërkuar nga gjykata e apelit përshpejtimin e gjykimit të çështjes, kërkesë që është rrëzuar. Kërkuesi ka pretenduar se çështja nuk është komplekse, pasi Gjykata e Lartë i ka përcaktuar detyrat për gjykatën e rigjyimit dhe në rastin e tij, për më tepër, nuk është zbatuar jurisprudenca kushtetuese që ka elaboruar standardin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm.

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave ligjore, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se me vendimin e datës 7.10.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është pranuar kërkesëpadia e paraqitur nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane (paditësi i kundërpaditur) dhe pjesërisht kundërpadia e kërkuesit (i paditur kundërpaditës), vendim që është lënë në fuqi me vendimin e datës 9.6.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Këto vendime janë prishur me vendimin e datës 26.11.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe çështja është kthyer për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka deklaruar moskompetencën lëndore dhe i ka dërguar aktet Gjykatës së Apelit Vlorë, vendim që është prishur me vendimin e datës 18.1.2018, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke e kthyer çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat për vazhdimin e gjykimit. *Për rrjedhojë*, në datën 14.2.2018 çështja e kërkuesit është regjistruar në atë gjykatë me nr. 555/103/65/61/56/55/47 regjistri.

18. Në pritje të shqyrtimit të çështjes së tij, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me kërkesën e datës 8.4.2025 për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, për të cilën ajo gjykatë, me vendimin nr. 918 (30-2025-5519), datë 25.6.2025, ka vendosur rrëzimin, duke vlerësuar se nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme nga gjyqtarja relatore.

19. Gjykata vëren se gjatë shqyrtimit të kërkesës për konstatimin e cenimit në gjykatën e apelit, me shkresën e datës 24.4.2025 "*Dhënie mendimi*", gjyqtarja relatore e çështjes së kërkuesit ka renditur ecurinë e gjykimit, duke sqaruar: për shkak të ndryshimeve të përsëritura të trupit gjykues gjatë këtyre viteve, largimeve të gjyqtarëve për shkak të rivlerësimit kalimtar dhe komandimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor është pamundësuar vijimi normal dhe i pandërprerë i shqyrtimit gjyqësor të çështjes; çështja është shqyrtuar pranë trupit gjykues aktual në datën 23.10.2023, datë e cila përkon me fillimin e detyrës së asaj gjyqtareje në atë gjykatë; nga kjo datë dhe në vijim trupi gjykues ka qenë në pamundësi të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, për shkak të lejeve shëndetësore, si dhe pushimeve vjetore të përcaktuara në ligj të gjyqtarës relatore; në datën 20.1.2025 është planifikuar zhvillimi i seancës së parë në datën 31.3.2025, e cila nuk është zhvilluar për shkak të një gabimi njerëzor në planifikim, pasi përkonte me ditë pushimi zyrtar dhe seanca tjetër është planifikuar në muajin maj 2025.

20. Në përgjigje të informacionit që i është kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat gjatë shqyrtimit paraprak të ankimit kushtetues individual të kërkuesit, me shkresën nr. 2499/1, prot., datë 29.12.2025, ajo gjykatë ka informuar: "*Çështja*

e kërkuessit është duke u gjykuar dhe ndodhet në fazën ku është paraqitur akti i ekspertimit dhe do të relatohet nga ekspertët. Për arsye të njoftimit të ekspertëve seanca gjyqësore është shtyrë për në datën 26.1.2026, ora 13:15.”. Në vijim, por në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Gjykata për gjendjen në të cilën ndodhet gjykimi i çështjes së kërkuessit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me shkresën nr. 336/1, prot., datë 12.2.2026, ka informuar: “Sipas verifikimeve të kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore rezultoi se çështja e kërkuessit është në proces gjykimi dhe seanca gjyqësore për shqyrtimin e saj është planifikuar në datën 17.3.2026, ora 14:00.”.

21. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se nga data e regjistrimit për herë të parë të çështjes së kërkuessit në gjykatë dhe deri në paraqitjen e ankimit kushtetues individual ka kaluar një periudhë kohore prej 18 vjetësh, kurse nga regjistrimi i saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, pas prishjes së vendimit të moskompetencës (datë 14.2.2018), ka kaluar një periudhë prej 8 vjetësh dhe kërkuessi nuk ka ende një vendim përfundimtar për titullin e tij të pronësisë. Gjykata, në mbështetje të nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile, vëren se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuessit ka tejkaluar afatin 2-vjeçar të përcaktuar nga ligji si një afat i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit në shkallën e parë. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuessit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ajo do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkuessit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuessi (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Lidhur me sjelljen e kërkuessit, Gjykata çmon se ajo nuk ka qenë shkak për vonesën në gjykimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, kurse në lidhje me sjelljen e autoriteteve vëren se vonesa ka ardhur si shkak i mosveprimit të gjykatës së shkallës së parë për një periudhë të gjatë kohore pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë e lidhur kjo me ndryshimet e përsëritura të trupit gjykues, për shkak të largimeve të gjyqtarëve si pasojë e reformës në drejtësi, sikundër me periudhën e lejes shëndetësore të gjyqtarës relatore ose për shkak të një gabimi njerëzor në planifikimin e seancës gjyqësore. Për rrjedhojë, sjellja e gjykatës ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit gjyqësor të kërkuesses.

23. Për sa i përket kompleksitetit të çështjes, Gjykata vëren se sipas gjykatës së apelit, që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit, vonesa justifikohet nga kompleksiteti i çështjes për shkak të volumit të lartë të dosjes gjyqësore, si dhe nevoja për përgatitje të kujdesshme nga trupi gjykues i sapocaktuar për një shqyrtim të drejtë dhe efektiv të saj. Gjykata, pa e mohuar kompleksitetin e çështjeve të tilla, për shkak të volumit të madh të akteve të dosjes gjyqësore dhe natyrës së tyre, vlerëson se kohëzgjatja tërësore e procesit gjyqësor, pra periudha kohore që ka kaluar që prej regjistrimit të saj për herë të parë (18 vjet), ashtu edhe kohëzgjatja prej 8 vjetësh pa u kryer asnjë veprim nga gjykata e shkallës së parë ku çështja është kthyer për rigjykim, nuk mund të justifikohet nga kompleksiteti i saj, për rrjedhojë ai nuk mund të konsiderohet në këtë analizë si një faktor përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit gjyqësor.

24. Kurse për sa i përket kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuessi*, Gjykata ka theksuar se ai përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Gjykata ka theksuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përsheptim të posaçëm të gjykimit. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, duhet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Në këto raste duhet të merret parasysh rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuessi në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për të e drejta objekt gjykimi. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuessit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 65, datë 2.10.2024; nr. 67, datë 7.12.2023; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin kur çështja gjyqësore ka në objektin e saj të drejtën e pronës

private, Gjykata ka theksuar se zgjidhja përfundimtare e problemeve që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si çështje jo vetëm me interes publik, por, para së gjithash, me natyrë kushtetuese, përbën prioritet, pasi e drejta e pronës përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit (*shih vendimin nr. 1, datë 6.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka e drejta kushtetuese e pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, si dhe e drejta e kompensimit sipas kuadrit ligjor në fuqi, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikojnë palët në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata vëren se thelbi i mosmarrëveshjes në gjykim përpara gjykatës së shkallës së parë ka të bëjë me mbrojtjen e së drejtës së pronës, për sa kohë që në atë gjykim është vënë në diskutim ligjshmëria e titullit të pronësisë të kërkuesit (vendimi nr. 3/1999 i KKKP-së, Skrapar) në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave gjatë regjimit të kaluar për kthimin e plotë të sipërfaqes së pronës së pretenduar prej tij. Në këto kushte, për sa kohë që kjo çështje është ende në pritje të shqyrtimit të saj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm që prej 8 vjetësh, që nga regjistrimi i saj pas kthimit për rigjykim në shkallë të parë, pa pasur ende kërkuesi një vendim në lidhje me objektin e atij gjykimi, si dhe duke pasur parasysh edhe kohëzgjatjen e mundshme të gjykimit në shkallët e tjera të gjykimit në rast të ankimit të vendimit nga pala gjyqhumbe, kohëzgjatja e gjykimit, e parë në këndvështrim edhe të kohëzgjatjes tërësore të procedurave, merr rëndësi në drejtim të asaj që rrezikon kërkuesi si titullar i së drejtës së pronës private të cilën ai kërkon që të mbrojë në procesin civil. Për rrjedhojë, kjo çështje, për nga natyra e saj, është e tillë që duhet të shqyrtohet me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

26. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, Gjykata, duke pasur parasysh periudhën gjatë së cilës çështja e kërkuesit është në pritje të shqyrtimit në gjykatën e shkallës së parë, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

27. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të pranohet, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 918, datë 25.6.2025, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
 3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm në shqyrtimin e çështjes civile nr. 555/103/65/61/56/55/47 regjistri, datë 14.2.2018, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.3.2026.

Shpallur më 10.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Ilir Toska,
Sandër Beci, Asim Vokshi